<p>Neni 7</p>	<p>Aplikimi për leje</p> <p>Shtetet Anëtare duhet të marrin masa në mënyrë që kërkesa për leje për landfill të përmbajë të paktën detajet e mëposhtme:</p> <p>(a) identitetin e aplikantit dhe të operatorit kur janë subjekte të ndryshme; (b) përshkrimin e llojeve dhe sasisë totale të mbetjeve që do të depozitohen; (c) kapaciteti i propozuar i vendit të asgjësimit; (d) përshkrimin e vendndodhjes, duke përfshirë karakteristikat e saj hidrogeologjike dhe gjeologjike; (e) metodat e propozuara për parandalimin dhe pakësimin e ndoqjes; (f) planin e propozuar të funksionimit, monitorimit dhe kontrollit; (g) planin e propozuar për mbylljen dhe procedurat e kujdesit pas mbylljes; (h) kur kërkohet një vlerësim i ndikimit sipas Direktivës së Keshillit 85/337/KEE të 27 qershorit 1985 mbi vlerësimin e efektive të disa projekteve publike dhe private në mjedis, informacioni i dhënë nga zhvilluesi në përputhje me Nenin 5 të asaj Direktive; (i) sigurua financiare nga aplikanti, ose qdo dispozitë tjetër ekuivalente, siç kërkohet sipas Nenit 8(a)(iv) të kësaj Direktive.</p> <p>Pas një aplikimi të suksesshëm për leje, ky informacion do t'u vihet në dispozicion autoriteteve statistikore kombëtare dhe të Komunitetit kompetente kur kërkohet për qëllime statistikore.</p>		<p>Neni 8</p>	<p>Kërkesa për leje mjedisi</p> <p>1. Në përputhje me ligjin nr. 10/448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", kërkesa për lejen e mjedisit, e tipit A ose B, për një landfill, përfshin edhe informacion për: a) identitetin e kërkesit dhe të operatorit, kur ata janë entitete të ndryshme; b) përshkrimin e llojeve dhe sasive totale të mbetjeve që do të asgjësohen, të identifikuara nga kodi përkatës sipas Katalogut të Mbetjeve; c) kapacitetin e propozuar të landfillit, si dhe volumin e nevojshëm për depozitimin e mbetjeve dhe volumin e materialeve të përdorura për mbulime ditore; ç) përshkrimin e vendit, përfshirë edhe karakteristikat e tij hidrogeologjike e gjeologjike, gjeoteknike, me qëllim identifikimin e natyrës së tokave dhe masiveve shkëmbore të pranishme në zonë dhe skemën e garkullimit të ujërave nëntokësore, të shoqëruar nga një matje të detajuar gjeologjike dhe një hetim të detajuar stratigrafik, i realizuar me marrjen e mostrave dhe provave përkatëse laboratorike në përputhje me dekreten e 11 marsit 1988 të Ministrit të Punëve Publike, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 127 të 1 qershorit 1988, si dhe vlerësimin e të gjitha madhësive fiziko-mekanike që kontribuojnë në zgjedhjen e vendndodhjes së veprës, projektimin dhe funksionimin e saj, siç është parashikuar nga Normat Teknike për Nderesat në fuqi; d) metodat e propozuara për parandalimin dhe pakësimin e niveleve të ndoqjes; dh) planet e propozuara të operacioneve, monitorimit dhe të kontrollit;</p>	<p>E plotë</p>	

Neni 8 Kushtet e lejes			Neni 9 Kushtet për pajisjen me lege mjedisi	<p>c) planin e propozuar për mbylljen e landfillit dhe procedurat e kujdesit pas mbylljes;</p> <p>ë) raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në rasti se, në zbatim të ligjit nr. 10/440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, është kërkuar një i tillë, dhe çdo informacion që është dhënë nga zhvilluesi;</p> <p>Ë garantci financiare nga kërkuesi, sic parashikohet nga neni 36, i ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.</p>	E plote	
Neni 8 germa a	<p>Shtetet Anëtare duhet të marrin masa në mënyrë që:</p> <p>(a) autoriteti kompetent nuk leshon leje për landfill nëse nuk është i bindur se:</p> <p>(i) pa cenuar nenin 3(4) dhe (5), projekti i landfillitë përputhet me të gjitha kërkesat përkatëse të kësaj Direktive, duke përfshirë Shtojcat;</p> <p>(ii) menaxhimi i landfillit do të jetë në duart e një personi fizik që është teknikisht kompetent për të menaxhuar vendin; ofrohet zhvillimi profesional dhe teknik dhe trajnimi i operatorëve dhe stafit të landfillitë ;</p> <p>(iii) landfilli duhet të operohet në një mënyrë të tillë që të merren masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;</p> <p>(iv) aplikanti ka marrë ose do të marrë dispozita të mjaftueshme, nëpërmjet një sigurie financiare ose çdo ekuivalenti tjetër, në bazë të modaliteteve që do të vendosen nga Shtetet Anëtare, përpara fillimit të operacioneve të asgjësimit për të siguruar që detyrimet (përfshirë dispozitat e kujdesit pas asgjësimit) që rregullojnë nga leja e leshuar sipas dispozitave të kësaj Direktive të pëmbushen dhe që të ndiqen procedurat e mbylljes të këtuara nga Neni 13. Kjo siguri ose ekuivalenti i saj duhet të mbahet për aq kohë sa kërkohet nga mirëmbajtja dhe funksionimi i kujdesit pas asgjësimit të vendit në përputhje me Nenin 13(d). Shtetet Anëtare mund të deklarojnë, sipas zgjedhjes së tyre, se kjo pikë nuk zbatohet për landfillet e mbetjeve inerte;</p>		Neni 9 pika 1 germa dh	<p>1. Në përputhje me ligjin nr. 10/448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk miraton kërkesën për leje mjedisi për landfillin, në goftë se nuk është e bindur që plotësohen kushtet si më poshtë:</p> <p>a) projekti i landfillit është në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të legjislacionit në fuqi dhe të këtij vendimi;</p> <p>b) drejtuesi teknik që do të menaxhojë vendin e landfillit ka kapacitetin e duhur teknik e menaxherial për këtë qëllim, të vërtetuar përmes dokumentacionit përkatës;</p> <p>c) operatorëve dhe stafit të landfillit u ofrohen trajnime nga ana profesionale dhe teknike;</p> <p>c) landfilli do të operohet duke ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin e aksidenteve dhe për kufizimin e pasojave të tyre;</p> <p>d) janë marrë masat e duhura, përmes një garancie financiare, para fillimit të operacioneve të asgjësimit, që sigurojnë plotësimin e të gjitha detyrimeve, përfshirë ato për kujdesin pas mbylljes, të përcaktuara në lejen e mjedisit, dhe që janë ndjekur procedurat e mbylljes, të këtuara nga ligji nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe nga ky vendim. Kjo garantci ose ekuivalenti i saj mbahet për aq kohë sa kërkohet për kryerjen e operacioneve të mirëmbajtjes e të kujdesit pas mbylljes të landfillit, në përputhje me parashikimet e nenit 13.</p> <p>Kjo kërkesë nuk zbatohet për landfillet e mbetjeve inerte dhe landfillet e administruara nga AKEM, në përputhje me pikën 5 të nenit 36 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;</p>	E plote	
Neni 8 germa b	<p>(b) projekti i landfillit është në përputhje me planin ose planet përkatëse të menaxhimit të mbetjeve të përmendura në nenin 7 të Direktivës 75 /442/ EEC;</p>			<p>dh) projekti i landfillit është në përputhje me planet përkatëse të menaxhimit të mbetjeve, të referuara në nenet 63, 64 e 65 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.</p>	E plote	

Neni 8 germa c	(c) para fillimit të operacioneve të asgjesimit, autoriteti kompetent duhet të inspektojë vendin për të siguruar që ai përpunohet me kushtet përkatëse të lejes. Kjo nuk do të zvogëlojë në asnjë mënyrë përgjegjësinë e operatorit sipas kushteve të lejes.		Neni 11 Pika 2	2.Operatori, para fillimit të operacioneve të landfillit, verifikon vendin e caktuar të landfillit, me qëllim që të sigurohet se vendi i propozuar është në përputhje me të gjitha kushtet përkatëse të lejes së mjedisit.	E plotë	Ezaurkohet me nenin 69 të Ligjit 57/2025 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
Neni 9 Përmbajtja e lejes			Neni 10 Përmbajtja e lejes së mjedisit për landfillin		E plotë	
Neni 9	Duke specifikuar dhe plotësuar dispozitat e përcaktuara në Nenin 9 të Direktivës 75/442/KEE dhe Nenin 9 të Direktivës 96/61/KE, leja e landfillit duhet të përcaktojë të paktën sa vijoni: (a) klasa e landfillit; (b) listën e llojeve të përcaktuara dhe sasinë totale të mbetjeve që autorizohen të depozitohen në landfill; (c) kërkesat për përgatitjen e landfillit, operacionet e landfillit dhe procedurat e monitorimit dhe kontrollit, duke përfshirë planet e emergjencës (Shtojca II, pika 4 B), si dhe kërkesat e përkohshme për operacionet e mbylljes dhe kujdesit pas mbylljes; (d) detyrimin e aplikantit për të raportuar të paktën një herë në vit tek autoritetin kompetent mbi llojet dhe sasinë e mbetjeve të asgjesuara dhe mbi rezultatet e programit të monitorimit, siç kërkohet në nenet 12 dhe 13 dhe Shtojcën III.		Neni 10 Pika 1	1. Leja e mjedisit e tipit A ose B për një landfill përfshin përveç kushteve të parashikuara në përputhje me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, edhe informacionin dhe kërkesat në vijim, për: a) kategorinë e landfillit; b) listën e llojeve të përcaktuara të mbetjeve që lejohen të depozitohen në landfill; c) sasinë totale të mbetjeve që lejohet të depozitohet në landfill; d) kërkesat për përgatitjen e landfillit, operacionet e asgjesimit në landfill dhe procedurat e vetëmonitorimit e të kontrollit të landfillit, përfshirë edhe planet e emergjencës (Shtojca III, seksioni 4.2); d) kërkesat kushtëzuese për operacionet e mbylljes dhe të kujdesit pas mbylljes; dn) detyrimin e operatorit për të raportuar, të paktën, një herë në vit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për llojet dhe sasinë e mbetjeve të asgjesuara dhe për rezultatet e programit të vetëmonitorimit, në bazë të neneve 12 dhe 13 dhe Shtojcës III të këtij vendimi.	E plotë	
Neni 10 Kostoja e landfillit të mbetjeve	Shtetet Anëtare duhet të marrin masa për të siguruar që të gjitha kostot e përfshira në ngritjen dhe funksionimin e një vendi për landfill mbetjesh, duke përfshirë, për aq sa është e mundur, koston e sigurisë financiare ose ekuivalentin e saj të përmendur në Nenin 8(a)(iv), dhe kostot e vlerësuar të mbylljes dhe kujdesit pas landfillit të vendit për një periudhë prej të paktën 30 vjetësh, të mbulohen nga ymimi që do të ngarkohet nga operatori për asgjesimin e çdo lloji mbetjeje në atë vend. Në varësi të kërkesave të Direktivës së Keshillit 90/313/EE të 7 qershorit 1990 mbi lirinë e aksesit në informacion mbi mjedisin Shtetet Anëtare sigurojnë transparencë në mbledhjen dhe përdorimin e çdo informacioni të nevojshëm mbi koston.	T të konsiderohen dispozitat sipas ligjit 57.2025 "për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	Neni 16 Rregullat për garancinë financiare Pika 1	1. Tarifa e përcaktuar nga operatori, për asgjesimin e mbetjeve në landfill, në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" mbulon koston e projektimit dhe operimit të landfillit, si edhe koston e garancisë financiare të kërkuar në nenin 36 të këtij ligji dhe garancinë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillit për një periudhë prej të paktën 30 (tridhjetë) vitesh.	E plotë	
		Neni 36 Garancie financiare për landfill-in 1. Çdo person, që operon ose ka për qëllim të operojë një landfill, në përputhje me lejen e mjedisit,				

		<p>duhet të disponojë dhe të sigurojë të gjitha mjeket financiare të nevojshme për të mbuluar kostot e ndërtimit dhe të operimit.</p> <p>2. Cdo person, që operon ose ka për qëllim të operojë një landfill, në përputhje me lejen e mjedisit, duhet të sigurojëgarancin e për kostot e mbyljes së landfill-it, ndërhijet e nevojshme pas mbyljes së landfill-it dhe rehabilitimitin e mjedisit.</p> <p>3. Periudha e nevojshme për kujdesin e mëtejshëm për landfill-in është të paktën 30 vjet nga mbyllja e landfill-it. 4. Keshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat dhe procedurat për garancitë financiare të landfill-it, ku përfshihen:</p> <p>a) objekti dhe kohëzgjatja e garancive;</p> <p>b) vlera, lloji dhe mënyra e llogaritjes së garancive;</p> <p>c) formati dhe procedura e</p>		
--	--	--	--	--

<p>Neni 11 Procedurat e pranimit të mbejve</p>		<p>miratimit të garancive; ç) procedura për zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me garancitë; d) autoriteti kompetent për vlerësimin dhe zbatimin e garancive; 5. AKEM-i përgjashtohet nga të gjitha detyrimet për garancitë financiare të landfili-it.</p>	<p>Neni 11 Procedurat e pranimit të mbejve në landfill</p>		<p>E plotë</p>
<p>Neni 11 Pika 1 Germa a</p>	<p>1. Shtetet Anëtare marrin masa në mënyrë që, përpara pranimit të mbejveve në vendin e landfillit: (a) para ose në kohën e dorëzimit, ose të dorëzimit të parë në një seri dorëzimesh, me kusht që lloji i mbejveve të mbetet i pandryshuar, mbajtësi ose operatori mund të tregojë, me anë të dokumentacionit të duhur, se mbetjet në fjalë mund të pranohen në atë vend sipas kushteve të përcaktuara në leje dhe se ato përmbushin kriteret e pranimit të përcaktuara në Shojcën II;</p>		<p>Neni 11 Pika 1</p>	<p>1. Zotënesi i mbejveve, përpara apo gjatë dorëzimit të mbejveve në vendin e landfillit, ose përpara apo gjatë dorëzimit të parë të një serie dorëzimesh të të njëjtit lloj mbejvesh, i tregon operatorit me anë të dokumentacionit shoqëruar të mbejveve, se: a) në përputhje me kushtet e lejes së mjeditsit, mbetjet mund të pranohen në këtë vend; b) ai i përmbush kriteret e pranimit, të përcaktuara në Shojcën II</p>	<p>E plotë</p>
<p>Neni 11 Pika 1 Germa b</p>	<p>(b) operatori respekton procedurat e mëposhtme të prijës: — kontrollimi i dokumentacionit të mbejveve, duke përfshirë ato dokumente të kërkuara nga Neni 5(3) i Direktives 91/689/KEE dhe, aty ku zbatohen, ato të kërkuara nga Rregulloria e Këshillit (KEE) Nr. 259/93 e 1 shkurtit 1993 mbi mbikëqyjen dhe kontrollin e transportit të mbejveve brenda, brenda dhe jashtë Komunitetit Evropian; — inspektim vizual i mbejveve në hyrje dhe në pikën e depozitimit dhe, sipas rastit, verifikimi i konformitetit me përshtirimin e dhënë në dokumentacionin e paraqitur nga mbajtësi. Nëse duhet të merren mostra përfaqësuese për të zbatuar Shojcën II, pika 3, niveli 3, rezultatet e analizave duhet të ruhen dhe marrja e mostrave duhet të bëhet në përputhje me Shojcën II, pika 5. Këto mostra duhet të ruhen të pakten një muaj; — mbajtja e një regjistri të sasive dhe karakteristikave të mbejveve të depozituara, duke treguar origjinën, datën e dorëzimit, identitetin e prodhuesit ose mbledhësit në rastin e mbejveve bashkëtaqe dhe, në rastin e mbejveve të rrezikshme, vendndodhjen e saktë në vend. Ky informacion duhet t'u vihet</p>		<p>Neni 11 Pika 3</p>	<p>3. Operatori, para pranimit të mbejveve në vendin e landfillit, kryen procedurat e mëposhtme të hyrjes: a) kontrollon dokumentacionin shoqëruar të mbejveve; b) inspektion me sy mbetjet në hyrje të vendit të landfillit dhe në pikën e depozitimit; c) verifikon përputhshmërinë e mbejveve me përshtirimin e dhënë në dokumentacionin e dorëzuar nga mbajtësi; ç) kur në zbatim të kërkesave të seksionit 1.3 të Shojcës II, për verifikimet në vend, merren dhe analizohen mostra përfaqësuese të cilat ruhen për, të pakten, 1 (një) muaj; dh) plotëson regjistrin përkatës me sasi të dhe karakteristikat e mbejveve të depozituara, duke shënuar origjinën, datën e dorëzimit, identitetin e krijuesit ose të grumbulluesit të mbejveve bashkëtaqe, kurse në rastin e mbejveve të rrezikshme shënon edhe vendndodhjen e saktë. Ky informacion i vihet</p>	<p>E plotë</p>

	<p>në dispozicion autoriteteve statistikore kombëtare dhe të Komunitetit kompetente kur kërkohet për qëllime statistikore.</p>				<p>në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese.</p>		
<p>Neni 11 Pika 1 Gërma c</p>	<p>(c) operatori i landfillit duhet të japë gjithmonë një konfirmim me shkrim të marrjes së qdo dërgese të pranuar në vend;</p>		<p>Neni 11 Pika 3 Gërma d</p>		<p>d) Ieshon dokument me shkrim për marrjen e qdo dërgese të pranuar në vend.</p>	E plotë	
<p>Neni 11 Pika 1 Gërma d</p>	<p>(d) pa cenuar dispozitat e Rregullores (KEE) nr. 259/93, nëse mbetjet nuk pranohen në një landfill, operatori duhet të njoftojë pa vonesë autoritetin kompetent për mospranimin e mbetjeve.</p>		<p>Neni 11 Pika 4</p>		<p>4. Operatori, në rast se nuk i pranon mbetjet në landfill, njofton menjëherë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për mospranimin e mbetjeve.</p>	E plotë	
<p>Neni 11 Pika 2</p>	<p>2. Për vendet e landfillleve të cilat janë përfshuar nga dispozitat e kësaj Direktive në bazë të Nenit 3(4) dhe (5), Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar:</p> <p>- inspektim i rregullt vizual i mbetjeve në pikën e depozitimit për të siguruar që në vend pranohen vetëm mbetje jo të rrezikshme nga ishulli ose vendbanimi i izoluar; dhe</p> <p>- të mbahet një regjistër për sasitë e mbetjeve që depozitohen në vend.</p>		<p>Neni 11 Pika 5</p>		<p>5. Operatori, për landfilllet sipas pikës 3 të nenit 3 të këtij vendimi, që përfshihen nga dispozitat e këtij vendimi:</p> <p>a) inspektion me sy, rregullisht, mbetjet në pikën e depozitimit, për të siguruar që në vend pranohen vetëm mbetje jo të rrezikshme nga ishulli ose nga qendra e banuar e izoluar;</p> <p>b) plotëson regjistrin për sasitë e mbetjeve që janë depozituar në vend.</p>	E plotë	
<p>Neni 12 Procedurat e kontrollit dhe monitorimit në fazën operative</p>			<p>Neni 12 Kontrolli dhe procedurat e vetëmonitorimit në fazën operationale</p>			E plotë	
<p>Neni 12 Gërma a</p>	<p>Shtetet Anëtare duhet të marrin masa në mënyrë që procedurat e kontrollit dhe monitorimit në fazën operative të përbushin të paktën kërkesat e mëposhme:</p> <p>(a) operatori i një landfill duhet të zbatojë gjatë fazës operative një program kontrolli dhe monitorimi siç specifikohet në Shtojcën III;</p>		<p>Neni 12 Pika 1</p>		<p>1. Operatori, gjatë fazës operationale të një landfilli, kryen procedurat e kontrollit dhe vetëmonitorimit, të specifikuara në Shtojcën III.</p>	E plotë	
<p>Neni 12 Gërma b</p>	<p>(b) operatori duhet të njoftojë autoritetin kompetent për çdo efekt të rëndësishëm negativ mjedisor të zbuluar nga procedurat e kontrollit dhe monitorimit dhe të ndjekë vendimin e autoritetit kompetent mbi natyrën dhe kohën e masave korrigjuese që duhen ndërmarrë. Këto masa duhet të ndërmerren me shpeztim të operatorit.</p> <p>Me një frekuencë që do të përcaktohet nga autoriteti kompetent, dhe në qdo rast të paktën një herë në vit, operatori duhet të raportojë, mbi bazën e të dhënave të agreguara, të gjitha rezultatet e monitorimit u dorëzohen autoriteteve kompetente me qëllim demonstrimin e pajtueshmërisë me kushtet e lejes dhe rrijen e njohurive mbi sjelljen e mbetjeve në landfill.</p>		<p>Neni 12 Pikat 2,3,4</p>		<p>2. Operatori informon Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për çdo ndikim negativ të rëndësishëm në mjedis, që mund të identifikohet gjatë kryerjes së procedurave të kontrollit dhe vetëmonitorimit.</p> <p>3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastet kur identifikohet ndonjë ndikim negativ i rëndësishëm në mjedis, njofton operatorin për të marrë masa dhe për kohën se kur ai duhet t'i marrë ato. Këto masa ndërmerren me shpeztim të operatorit.</p> <p>4. Leja e mjedisit specifikon periudhën kohore në të cilën operatori duhet të raportojë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe të gjitha rezultatet e vetëmonitorimit, sipas të dhënave të grumbulluara. Raportimi të jetë jo më pak se një herë në vit. Këto raporte përdoren për të rregulluar përfundimisht me kushtet e vendosura në lejen e mjedisit dhe për të rritur shkallën e njohjes për sjelljen dhe evolucionin e mbetjeve në landfill.</p>	E plotë	
<p>Neni 12 Gërma c</p>	<p>(c) kontrolli i cilësisë së operacioneve analitike të procedurave të kontrollit dhe monitorimit dhe/ose të</p>		<p>Neni 12 Pika 6</p>		<p>6. Kontrolli i cilësisë së operacioneve analitike të kontrollit e vetëmonitorimit dhe/ose të analizave, të</p>	E plotë	

	analizave të përmendura në nenin 11(1)(b) kryhen nga laboratorë kompetentë.				referuarra në pikën 3 të këtij neni kryhet nga laboratorë të specializuar.		
Neni 13 Procedurat e mbyljes dhe kujdesit pas operacionit		Neni 13 Procedurat e mbyljes dhe të kujdesit pas mbyljes				E plotë	
Neni 13 Germa a	Shtetet Anëtare marrin masa në mënyrë që, në përputhje me lejen, kur është e përshtatshme: (a) një landfill ose një pjesë e saj duhet të fillojë procedurën e mbyljes: (i) kur përbushen kushtet përkatëse të përcaktuara në leje; ose (ii) sipas autorizimit të autoritetit kompetent, me kërkese të operatorit; ose (iii) me vendim të asyrtuar të autoritetit kompetent;	Neni 13 Pika 1			1. Operatori i vendit të landfillit fillon procedurat e mbyljes për të gjithë vendin e landfillit ose për një pjesë të tij, vetëm kur: a) janë përbushur kushtet përkatëse, të përcaktuara në lejen e mjedisit; b) kërkesa e tij për mbyllje është miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit; c) kur kërkohet, me një vendim të argumentuar teknikisht, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.	E plotë	
Neni 13 Germa b	(b) një vendgrumbullim mbledhesh ose një pjesë e tij mund të konsiderohet si përfundimish i mbyllur vetëm pasi autoriteti kompetent të ketë kryer një inspektim përfundimtar në vend, të ketë vlerësuar të gjitha raportet e paraqitura nga operatori dhe ti ketë komunikuar operatorit miratimin e tij për mbylljen. Kjo nuk do të zvogëlojë në asnjë mënyrë përgjegjësinë e operatorit sipas kushteve të lejes;	Neni 13 Pika 2, 3, 5			2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përpara se të vendosë mbylljen ose jo të vendit të landfillit ose një pjesë të tij, kryen një verifikim teknik përfundimtar në vend dhe vlerëson të gjitha raportet e dorëzuara nga operatori. 3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlerëson se janë përbushur të gjitha kërkesat e vendosura në lejen e mjedisit për mbylljen e landfillit dhe që, vendi i landfillit nuk paraqet ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin, i komunikon, me shkrim, operatorit vendimin për miratimin e mbyljes së vendit të landfillit. 5. Miratimi i mbyljes së vendit të landfillit nuk ia pakëson përgjegjësinë operatorit për të përbushur kushtet e lejes së mjedisit, përfshirë edhe përgjegjësitë specifike që vijojnë	E plotë	
Neni 13 Germa c	(c) pasi një landfill të jetë mbyllur përfundimish, operatori është përgjegjës për mirëmbajtjen, monitorimin dhe kontrollin e tij në fazën e kujdesit pas mbyljes për at kohë sa mund të kërkohet nga autoriteti kompetent, duke marrë parasysh kohën gjatë së cilës landfilli mund të paraqesë rreziqe. Operatori duhet të njoftojë autoritetin kompetent për çdo efekt të rëndësishëm negativ mjedisor të zbuluar nga procedurat e kontrollit dhe duhet të ndjekë vendimin e autoritetit kompetent mbi natyrën dhe kohën e masave korrigjuese që duhen ndërmarrë;	Neni 13 Pika 5 Germa a, b			5. Miratimi i mbyljes së vendit të landfillit nuk ia pakëson përgjegjësinë operatorit për të përbushur kushtet e lejes së mjedisit, përfshirë edhe përgjegjësitë specifike që vijojnë: a) Operatori është përgjegjës për mirëmbajtjen, vetëmonitorimin dhe kontrollin e vendit të landfillit gjatë fazës së kujdesit pas mbyljes, për at kohë sa i kërkohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, duke marrë në konsideratë periudhën kohore gjatë së cilës vendi i landfillit mund të paraqesë rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin. b) Operatori njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për ndonjë ndikim negativ të rëndësishëm në mjedis, të zbuluar gjatë kryerjes së procedurave të kontrollit, dhe zbaton vendimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për natyrën, shkallën dhe afatin kohor të masave që duhen marrë.	E plotë	

<p>Neni 13 Germa d</p>	<p>(d) për aq kohë sa autoriteti kompetent konsideron se një landfill ka të ngjarë të shkaktojë rrezik për mjedisin dhe pa cennar asnjë legjislacion komunitar ose kombëtar në lidhje me përgjegjësinë e mbajtësit të mbetjeve, operatori i vendit është përgjegjës për montimin dhe analizimin e gazit dhe rjedhjeve të landfillit nga vendi dhe regjimin e ujërave nëntokësore në afërsi të vendit në përputhje me Shtojcën III.</p>		<p>Neni 13 Pika 5 Germa c</p>	<p>c) Operatori i vendit, pavarësisht nga legjislacioni në fuqi për përgjegjësinë e zotërnesit të mbetjeve, është përgjegjës, sipas kërkesave të Shtojcës III, për vëzhgimin dhe analizimin e gazrave të landfillit, të lëngjeve kulluese dhe të regjimit të ujërave nëntokësore në afërsi të vendit, për aq kohë sa Agjencia Kombëtare e Mjedisit e konsideron landfillin që mund të paraqesë rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin</p>	<p>E plote</p>	
<p>Neni 14 Vendet ekzistuese të landfilleve të mbetjeve</p>	<p>Shtetet Anëtare duhet të marrin masa në mënyrë që landfilllet të cilave u është dhënë leje, ose të cilat janë tashmë në funksionim në kohën e transpozimit të Kësaj Direktive, të mos vazhdojnë të funksionojnë nëse hapat e përshtiruar në poshtë nuk kryhen sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se tetë vjet pas datës së përcaktuar në Nenin 18(1):</p>		<p>Neni 14 Landfilllet ekzistuese të pajisura me leje mjedisit</p>		<p>E plote</p>	<p>Pëmbajtja e dispozites është e njëjtë me Direktivën por ndryshojnë afatet, të cilat janë subjekti i dakordimit me Komisionin e BE-së në procesin e negociimit për Kapitullin 27, bazuar në DSIP-në për Direktivën e Landfillit.</p>
<p>Neni 14 Germa a</p>	<p>(a) brenda një periudhe prej një viti pas datës së përcaktuar në Nenin 18(1), operatori i një landfill duhet të përgatisë dhe t'u paraqesë autoriteteve kompetente, për miratim, një plan kushëzimi për vendin, duke përfshirë detajet e listuara në Nenin 8 dhe çdo masë korrigjuese që operatori e konsideron të nevojshme për të përmbyshur kërkesat e kësaj Direktive, me përjashtim të kërkesave në Shtojcën I, pika 1;</p>		<p>Neni 14 Pika 2</p>	<p>2. Operatori i një landfilli i cili është pajisur me një leje mjedisit për landfill dhe që operon një landfill ekzistues mund të vazhdojë operimin e tij, vetëm nëse përgatit një plan përmirësimi të landfillit dhe e paraqet atë për miratim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sa më shpejtë dhe maksimalisht deri në datën 31.12.2028.</p>	<p>E plote</p>	<p>Pëmbajtja e dispozites është e njëjtë me Direktivën por ndryshojnë afatet, të cilat janë subjekti i dakordimit me Komisionin e BE-së në procesin e negociimit për Kapitullin 27, bazuar në DSIP-në për Direktivën e Landfillit.</p>

<p>Neni 14 Germa b, c</p>	<p>(b) pas paraqitjes së planit të kushitëzimit, autoriteti kompetentë marrin një vendim përfundimtar nëse operacionet mund të vazhdojnë në bazë të planit të lartpërmendur të kushitëzimit dhe kësaj Direktive. Shkretet Antëtare marrin masat e nevojshme për të mbyllur sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me nenin 7(§) dhe 13, vendet të cilave nuk u është dhënë, në përputhje me nenin 8, një leje për të vazhduar të funksionojnë;</p> <p>(c) në bazë të planit të miratuar të kushitëzimit të vendit, autoriteti kompetent autorizon punën e nevojshme dhe përcakton një periudhë kalimtare për përfundimin e planit. Çdo vendepozitim ekzistues duhet të përmbushë kërkesat e kësaj Direktive, me përjashtim të kërkesave në Shtojcën 1, pika 1, brenda tetë viteve pas datës së përcaktuar në Nenin 18(1);</p>		<p>Neni 14 Pikat 3-7</p>	<p>3. Plani i përmirësimit, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 9 të këtij vendimi. Landfilllet ekzistuese janë të përgjashuara nga plotësimi i kërkesave të seksionit 1 të Shtojcës 1.</p> <p>4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja e planit të përmirësimit, merr vendim nëse operacionet mund të vazhdojnë në bazë të planit të përmirësimit në përputhje me kërkesat e nenit 9.</p> <p>5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit dhe vendos për masat që duhen marrë dhe periudha e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre, periudhë e cila në çdo rast përfundon në datën 31.12.2038, e dërgon atë së bashku me relacionin shpjegues teknik për informacion pranë ministrit së përgjigjëse për mjedisin. Relacioni shpjegues përmban të dhëna mbi piktëzimin e landfillit, si dhe impaktin mjedisor, ekonomik e social të zonës ku ndodhet landfilli.</p> <p>6. Plani i përmirësimit i miratuar, masat e nevojshme dhe periudha e tranzicionit, e referuar në pikën 4, të këtij neni, janë pjesë e lejes së përditësuar të mjedisit për atë landfill ekzistues.</p> <p>7. Agjencia kryen të gjitha veprimet e nevojshme për rishikimin e kushteve të lejeve të mjedisit.</p> <p>8. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbyllur landfillin ekzistues sa më parë të jetë e mundur, i propozon Ministrin përgjegjës për mjedisin mbylljen e tij, dhe i kërkon operatorit të zbatojë planin e propozuar për mbylljen dhe për kujdesin pas mbylljes, në përputhje me gërmen “e” të pikës 1 të nenit 8, dhe nenin 13 të këtij vendimi, në rastet e mëposhtme:</p> <p>a) Kur vendi i një landfilli ekzistues sipas mendimit të argumentuar të AKM-së, nuk mund të silltet në kushte që përputhen me këtë vendim, dhe/ose</p> <p>b) Kur vendi i një landfilli ekzistues nuk arrin të pajiset me leje mjedisi, në përputhje me kërkesat e nenit 9 të këtij vendimi;</p> <p>c) Kur operatori kërkon mbylljen e landfillit ekzistues.</p>	<p>E plotë</p>	<p>Përmbajtja e dispozitës është e njëjtë me Direktivën por ndryshojnë afatet, të cilat janë subjekt i dakordësimit me Komisionin e BE-së në procesin e negociimit për Kapitullin 27, bazuar në DSIP-në për Direktivën e Landfillit.</p>
<p>Neni 14 Germa d</p>	<p>(d)</p> <p>(i) brenda një viti pas datës së përcaktuar në Nenin 18(1), nenet 4, 5 dhe 11 dhe Shtojca II do të zbatohen për landfillet e mbejleve të rezikshme;</p> <p>(ii) brenda tre viteve pas datës së përcaktuar në nenin 18(1), neni 6 zbatohet për landfillet e mbejleve të rezikshme.</p>			<p>N/A</p>		
<p>Neni 15 Raportimi</p>			<p>Neni 22 Raportimet</p>			

	<p>1. Shtetet Anëtare duhet t'i raportojnë Komisionit të dhënat në lidhje me zbatimin e nenit 5(2), (5) dhe (6) për çdo vit kalendarik.</p> <p>Ata duhet t'i raportojnë të dhënat elektronikisht brenda 18 muajve nga fundi i vitit raportues për të cilin janë mbledhur të dhënat. Të dhënat duhet të raportohen në formatin e përcaktuar nga Komisioni në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni.</p> <p>Periudha e parë e raportimit mbi zbatimin e nenit 5(5) dhe (6) fillon në vitin e parë të plotë kalendarik pas miratimit të aktit zbatues që përcakton formatin për raportin, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, dhe mbulon të dhënat për atë periudhë raportimi.</p> <p>2. Shtetet Anëtare raportojnë të dhënat në lidhje me zbatimin e Nenit 5(2) deri më 1 Janar 2025.</p> <p>3. Të dhënat e raportuara nga Shtetet Anëtare në përputhje me këtë nen shpërndahen nga një raport kontrolli të cilësistë.</p> <p>4. Komisioni shqyrton të dhënat e raportuara në përputhje me këtë nen dhe publikon një raport mbi rezultatet e shqyrtimit të tij. Raporti vlerëson organizimin e mbledhjes së të dhënave, burimet e të dhënave dhe metodologjinë e përdorur në Shtetet Anëtare, si dhe plotësinë, besueshmërinë, afatet kohore dhe qëndrueshmërinë e këtyre të dhënave. Vlerësimi mund të përfshijë rekomandime specifike për përmirësim. Raporti hartohet pas raportimit të parë të të dhënave nga Shtetet Anëtare dhe çdo katër vjet më pas.</p> <p>5. Deri më 31 mars 2019, Komisioni miraton akte zbatuese që përcaktojnë formatin për raportimin e të dhënave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 17(2).</p>			<p>1. Ministria përgatit periodikisht një raport për zbatimin e këtij vendimi dhe, në mënyrë të veçantë, të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbrojtjes dhe Planit të Veprimit, për arritjen e objektivave të përcaktuara në nenet 16 dhe 17 të këtij vendimi.</p> <p>2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, AKEM sh.a. dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore i sigurojnë Ministrisë të gjithë informacionin mjedisor të nevojshëm për përgatitjen e raportit të referuar në pikën 1 të këtij neni.</p> <p>3. Raporti i referuar në pikën 1, vihet në dispozicion të publikut.</p>	N/A	
<p>Neni 15a Instrumente për të promovuar një kalim në një ekonomi më garkulluese</p>	<p>Për të kontribuar në objektivat e përcaktuara në këtë Direktivë, Shtetet Anëtare duhet të përdorin instrumente ekonomike dhe masa të tjera për të ofruar stimuj për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve. Instrumente dhe masa të tilla mund të përfshijnë ato të treguara në Shojcën IVa të Direktivës 2008/98/KE ose instrumente dhe masa të tjera të përshatshme.</p>				N/A	
<p>Neni 15b Përcaktimi i koeficientit të përshkueshmërisë për landfilllet</p>	<p>Komisioni miraton akte zbatuese për të përcaktuar metodën që do të përdoret për përcaktimin e koeficientit të përshkueshmërisë për landfilllet, në terren dhe për të gjithë zgjerimin e vendit. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 17(2).</p>				N/A	
<p>Neni 15c Standardi i Bashkimit për marrjen e mostrave të mbetjeve</p>	<p>Komisioni miraton akte zbatuese për të zhvilluar një standard për marrjen e mostrave të mbetjeve. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 17(2). Derisa të miratohen këto akte zbatuese, Shtetet Anëtare mund të zbatojnë standardet dhe procedurat kombëtare.</p>				N/A	

Neni 16 Rishikimi i Aneksëve	Komisioni do t'i mbajë Aneksët nën shqyrtim dhe, kur është e nevojshme, do të bëjë propozime të përshtatshme legislative.				N/A	
Neni 17 Procedura e komisionit	1. Komisioni do të ndihmohet nga Komiteti i krijuar sipas nenit 39 të Direktivës 2008/98/KE. Ky komitet do të jetë një komitet sipas kuptimit të Rregullores (BE) nr. 182/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. 2. Kur bëhet referencë për këtë paragraf, zbatohet Neni 5 i Rregullores (BE) nr. 182/2011. Kur komiteti nuk jep mendim, Komisioni nuk e miraton projektaktin zbatues dhe zbatohet nëparagrafi i tretë i nenit 5(4) të Rregullores (BE) nr. 182/2011.				N/A	
Neni 18 Transpozimi	1. Shtetet Anëtare do të vënë në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të përbushur këtë Direktivë jo më vonë se dy vjet pas hyrjes së saj në fuqi. Ato do të informojnë menjëherë Komisionin për këtë. Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto masa, ato duhet të përbajnë një referencë për këtë Direktivë ose duhet të shqetësohen nga një referencë e tillë në rastin e publikimit të tyre zyrtar. Metodat e bërtjes së një referencë të tillë përcaktohen nga Shtetet Anëtare. 2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave të ligjit kombëtar që miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.				N/A	
Neni 19 Hyria në fuqi	Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi ditën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.				N/A	
Neni 20 Të adresuarit	Kjo Direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.				N/A	
SHTOJCA I KËRKESA TË PËRGJITHS HME PËR TË GJITHA KATEGORI TË E LANDFILLE VE			SHTOJCA I KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR TË GJITHA KATEGORI TË E LANDFILLEVE		E plotë	
SHTOJCA II PROCEDUR AT DHE KRITERET E PRANIMIT TË MBETJEVE		Annex II to Directive 1999/31/EC. Council Decision of 19 December 2002 establishing criteria and procedures for the acceptance of Waste at landfills pursuant to Article 16 of and Annex II to	SHTOJCA II PROCEDURAT DHE KRITERET E PRANIMIT TË MBETJEVE		E plotë	Shtojca II e VKM-eshë përpunuar plotësisht me Aneksin II të Direktivës së Landfillit dhe i është situar pjesa e dytë e saj, bazuar tek Shtojca - Kriteret dhe procedurat për pranimin

<p>SHTOJÇA III PROCEDURAT E KONTROLLIT DHE VETËMONITORIMI NË FAZAT E OPERIMIT DHE KUDESIT PAS MBYLLJES</p>		<p>Directive 1999/31/EC. (2003/33/EC)</p>	<p>SHTOJÇA III PROCEDURAT E KONTROLLIT DHE VETËMONITORIMI NË FAZAT E OPERIMIT DHE KUDESIT PAS MBYLLJES</p>		<p>E plotë</p>	<p>e mbetje në landfill - Council Decision of 19 December 2002 establishing criteria and procedures for the acceptance of waste at landfills pursuant to Article 16 of and Annex II to Directive 1999/31/EC. (2003/33/EC)</p>
<p>SHTOJÇA IV PLANI I ZBATIMIT QË DUHET TË DORËZOHET NË PËRPUTHJE ME NENI 5(6)</p>					<p>N/A</p>	<p>Është hartuar DSIP për përdhat tranzitore të këtuara për dispozita specifike në Direktivën e Landfillit</p>